

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 3

Kodi: 059

ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË LEXIMIT NË KLASAT E HERSHME

Tipi i programit: Themelor

Hyrje

Programi i trajnimit “Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme” është zhvilluar nga KEC, më shumë se një dekadë më parë, në kuadër të Programit për Arsimin Themelor (apo BEP, i financuar nga USAID) për të ndihmuar mësimdhënësit e shkollat në zhvillimin e shkathtësive relevante të shekullit 21 të nxënësit e shkollave fillore.

Në vitin 2012, Programi BEP ka bërë një vlerësim të të lexuarit në klasat e hershme, në 40 shkolla të Kosovës, duke shfrytëzuar një instrument të hartuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila shfrytëzohet në vendet partnere të USAID-it. Ky instrument quhet EGRA – Early Grade Reading Assessment (Vlerësimi i të lexuarit në klasat e hershme). EGRA për gjuhën shqipe është adaptuar nga BEP dhe ka marrë emrin A-EGRA (Albanian EGRA). Nga hulumtimi i zhvilluar, ka dalë se fëmijët e klasave të hershme më së dobëti qëndrojnë me të kuptuarit e të lexuarit (lexim-kuptimin) dhe me rrjedhshmërinë në të shprehur. Si rrjedhojë, është hartuar programi i trajnimit nga një grup punues i përbërë nga ekspertë ndërkombëtarë e vendorë dhe janë certifikuar mbi 4600 mësimdhënës klasorë.

Në vitin 2025, dy nga anëtarët e grupit punues që e kishin zhvilluar programin e trajnimit, i janë rrekur punës në rishikimin e tij, për ta përshtatur me zhvillimet e reja në arsim. Programi ka mbetur i pandryshuar në thelb, me strukturën dhe metodologjinë e njëjtë, por janë përshtatur e shtuar disa aktivitete, për ta bërë me lehtë të përthithshëm e të zbatueshëm për gjeneratat e reja të mësimdhënësve që ndërkohë janë futur në shërbim. Programi i rishikuar është ofruar për mbi 150 mësimdhënës të klasave fillore dhe është vlerësuar shumë lart nga mësimdhënësit e trajnuar.

Qëllimi i programit dhe rezultatet e pritura

T’u ofrohet mësimdhënësve të shkollës fillore një program pune që përqendrohet në zbatimin e teknikave dhe strategjive për të përmirësuar shkathtësitë e lexim-shkrimit të nxënësit e klasave të hershme.

Pas përfundimit të kursit, vijuesit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë fazat e zhvillimit të shkathtësive të lexim-shkrimit të fëmijëve të moshave të reja;
- Të dallojnë komponentët e lexim-shkrimit dhe t’i lidhin/përdorin ato në procesin e zhvillimit të shkathtësive gjuhësore të nxënësit;

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 3

- Të përvetësojnë strategji dhe teknika për rritjen e shkathtësive të nxënësve në vetëdije fonemike, fonetike, dëgjim-kuptim, lexim-kuptim, rrjedhshmëri dhe fjalor;
- Të identifikojnë llojet e vështirësive që nxënësit hasin në lexim dhe të përvetësojnë strategji për t'u ndihmuar atyre nxënësve;
- Të praktikojnë teknika të krijimit të librave, për të ushqyer shkathtësitë e të shkruarit të nxënësit;
- Të demonstrojnë shkathtësi për të analizuar aspektet gjinore dhe koherencën shoqërore në tekstet shkollore dhe librat tjerë për fëmijë;
- Të analizojnë mënyra të ndryshme për angazhimin e prindërve në zhvillimin e shkathtësive të shkrim-leximit të fëmijët e tyre.

Përmbajtja

Përmbajtja e trajnimit është ndërtuar mbi komponentët kryesorë të leximit dhe temat e tërthorta që e ushqejnë zhvillimin e shkathtësive të leximit. Temat kryesore që trajtohen përfshijnë:

- Vështrim i përgjithshëm mbi lexim-shkrimin
- Vlerësimi i leximit në klasat e hershme (EGRA)
- Dëgjim-kuptimi
- Vetëdija fonemike/tingullore
- Fonetika
- Rrjedhshmëria
- Fjalori
- Lexim-kuptimi
- Vlerësimi formues
- Të shkruarit
- Nxënësit me vështirësi në të lexuar
- Aspekti gjinor në literaturë
- Përfshirja e prindërve

Grupi i synuar

Programi i trajnimit, në radhë të parë, është konceptuar për t'u ofruar për të gjithë mësime dhënësit e shkollës fillore. Megjithatë, programi mund të ndiqet edhe nga profesionistët tjerë arsimorë në shkollë, që mund të ofrojnë mbështetje për mësime dhënësit, apo drejtpërdrejt për nxënësit, si: mësime dhënësit mbështetës, koordinatorët e cilësisë në shkollë, etj.

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 3

Forma e organizimit/kohëzgjatja

Programi i trajnimit “Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme” i ka 30 orë. Ai realizohet në formë të programit treditësh të trajnimit (18 orë), i shoqëruar me mbështetje gjatë punës në realizimin e teknikave të programit (12 orë). Forma e organizimit dhe kohëzgjatja është si vijon:

- Ofrimi i dy ditëve të para të trajnimit;
- Praktikimi i aktiviteteve të programit, mes ditës së dytë dhe ditës së tretë të trajnimit;
- Ofrimi i ditës së tretë të trajnimit;
- Zbatimi i teknikave të leximit në klasa dhe dokumentimi i këtij zbatimi nga ana e mësimitdhënësve, i shoqëruar me mbështetje dhe informata kthyes nga trajnerët.

Mësimitdhënësit këshillohen ta mirëmbajnë/plotësojnë më tej dosjen e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve, si pjesë e praktikës reflektive.

Vlerësimi/Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 30 orë (18 orë trajnimi si dhe 12 orë zhvillimi përmes punës në shkollë).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja aktive në trajnim, së paku në 90% të kohëzgjatjes së trajnimit; dhe
- Dokumentimi i:
 - zbatimit të së paku një teknike të leximit, mes ditës së dytë dhe të tretë;
 - zbatimit të së paku dy teknikave të leximit pas ditës së tretë të trajnimit.

Materialet e trajnimit

Dokumenti kryesor për trajnimin është udhëzuesi për trajnerë “Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat e hershme”, i përkrahur me fletat e punës (shtojcat), me prezantimin në Power Point, sipas ditëve të trajnimit. Për trajtimin e temave të programit përdoren edhe kartat me fjalët më të shpeshta, librat e nivelizuar dhe mini-librat. Po, ashtu, pjesëmarrësve pas trajnimit u dërgohet përmbledhja me libra të vegjël “Mini-libra” dhe doracaku për mësimitdhënës “Zhvillimi i shkathtësive të leximit në klasat fillore” (<https://kec-ks.org/wp-content/uploads/2023/07/BEP-Doracaku-i-leximit-Final.pdf>)